

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8SH-1

N 41

VOJSAVA NELO



Kur  
çelin  
ëndrrat

POEZI

8 SH - 1  
N 41

VOJSAVA NELO



13891

POEZI  
Kur  
çelin  
ëndrrat

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## Ë N D R R A T

Ku janë ëndrrat e bukura, ku flejnë?  
Ëndrrat u kthyen në fytyra të lumtura,  
ëndrrat u kthyen në shtegtarë të shpejtë  
mbi peizazhet e lëvizshme plot ngjyra.

Ikën ëndrrat e mia larg këtyre mëngjeseve,  
ikën tek alpet e largëta në Veri  
mes pranverës së zërave të fëmijëve,  
ku dhe vetë unë qesh si një fëmijë.

Shkoj mësuese pranë agimeve veriore,  
pranë fëmijëve të malësorve shtatçetinë  
dhe do të mbështetem si një copëz rivierë  
pranë livadheve alpine.

## UNË DHE GJYSHI

Në sofrën e drunjtë bukën shtruam  
bisedën si zakonisht nisëm atje  
fjalët na ikën ditëve të luftës.  
Eh! — psherëtiu gjyshi, — si kemi qenë dje!

Pranë sofrës e shqetësuar nisa poezinë,  
do të shkruaj dot vallë dhe unë për diçka?  
Dhe vargjeve m'u derdhën dallgë gruri,  
në vargje rrëmbimthi pushka derdhi krisma.

— Me ngjyrë gruri dhe fjalë pushke  
vargjet ngarkuar, bijo, t'i kesh.  
Pa ato as vargjet s'janë vargje  
dhe ti poeteshë e mirë s'mund të jesh.

# KUR ÇELIN ËNDRRAT

*Partisë*

Lulet mbeteshin të vyshkura  
mes barit dikur të shkelur,  
netët ishin më tepër pa hënë,  
dhe ditët pa diell ishin më tepër.

Por ikën e rrodhën rrëketë e ditëve  
dhe ikën plot dallgë lumenjtë, vitet  
dhe gonxhet çelën nga plumbat,  
dhe gonxhet çelën nga këngët.

Partia është pranvera më e bukur,  
që e bëri lule gonxhen time të ëndrrave  
emrin e saj do ta gjeni te buzët,  
do ta gjeni te sytë, te fillimi im i këngëve.

## DUART E MURATORËVE

1944

Ngrini ju qytetet e së nesërmes  
epoka të tëra çoni në këmbë,  
me duart e ashpra, me duart e bukura,  
që kurrë s'u lodhën nga gurët e rëndë.

Në çdo gur prekja e duarve të mira,  
gjurmët tuaja i shoh në muret shtatlartë  
ato më mbetën në sy si peizazhe të bukura,  
më mbetën në zemër dhe te ky varg.

Përse ma fyen ëndrrën, o mikrobotë, e struktur  
 në ndërgjegjen e një njeriu të vetëm.  
 Në së vargjet e mi s'janë aq të bukur  
 kështu ndoshta s'do të jenë edhe nesër.

Po si mund ta fyesh fëmijën në rritje  
 pse fjalët dhe t'i belbëzoj mirë nuk di.  
 Në qoftë se ti do ta shikosh atë me indiferencë  
 të tjerët do t'i japin dorën me dashuri.

# M A L Ë S O R J A

Hyn në auditor e bukur si vet bjeshkët  
me flokët e derdhura në ngjyrën e vjeshtës.

Ti zbritë nga bjeshkët, nga viset e largëta,  
nëpër mend të vijnë gjithë ëndrrat e vrara.

Ëndrrat e gjakosura nga kanuni i lashtë  
dhe ti që u ngrite mbi gërmadhat e tij.

Kur qepallat e zez pulit nganjëherë  
më kujton pishat që zhvendosen nga era.

Bjeshkët seç të rritën porsì lule bore  
mësuese — të thonë cicërimat fëminore.

Ecën nëpër bjeshkë mes zërash të gëzuar  
si gjethe vjeshte nën këmbë botë e vjetër, e  
thërrmuar.



## BIJ AKSIONESH

Ne u ngjitëm në shpate një mbrëmje  
dhe thyem qetësinë përgjithmonë  
si sy të bukur dukeshin yjet,  
hëna pasqyrë për rininë tonë.

S'mund të harrojmë ato ditë të kaltra,  
në kujtesë rrjedhin si ujëvara të dlira,  
në pëllëmbët e mia le të mbeten kallot,  
atdheut le t'i mbetet rinia!

## O KJO DASHURIA

Fytyrën ma poqi dielli  
tëk mblihdja kallza në arë:  
Ç'na freskoi ky burimi  
ishte hëna në të dalë.

Pranë burimit tek kaluam  
sytë e njëri tjetrit pamë,  
si të dehur nga gëzimi  
yjet prapa malit shkanë.

U spërkatëm me kujdes  
me kristale nga burimi  
dhe u çelën sytë e zez  
si dy gonxhe trëndafili.

O kjo dashuria jonë  
pranë tokës kaq e ngrohtë.  
Vallë thua se do të ketë  
më të bukur, më të fortë?

## O FANTAZI E FËMIJËVE: ADI MALI

Fëmijët ngrejné qytete të tëra  
çdo verë buzë detit kur vijnë.  
Sa herë që u prishen ndërtojnë të tjerë  
në çast ia krijojnë të re planimetrinë.

Shkuma e bardhë pranë nis të mbulojë rrugët  
bulevardet, uzinat, lulishtet e ngritura  
po fëmijët më tej ngrejné një qytet tjetër  
me pirgje rëre, pranë dallgëve të pabindura.

O fantazi e fëmijëve më e pasur se deti,  
që sot hedh farën e qyteteve të reja,  
nesër qytetet që do të ngresh një nga një  
s'do të tunden nga dallgët, s'do të pyesin nga  
era.

## JAM DASHURUAR

Sa shumë drita sonte në fshat  
zënë dorë për dorë si valle e pambaruar  
dhe nuk dua të iki, jo, aspak  
nga ky vend, me të jam dashuruar.

Me njerëzit e thjeshtë, të urtë, e të mirë  
njerëzit e agimeve larë me diell,  
kokunjur janë ata si kalliri i pjekur,  
si ata qofshin këngët e mia!

## O JONI YNË

Përse në gjoks më derdhe shpirtin tënd  
dhe unë kaq shumë ngjaj me ty?  
Unë kurrë nuk jam e qetë  
në shpirt më tingëllojnë përherë melodi.

O Jon kreshtëbardhë, rënë në dashuri  
me bregun e bukur si në përrallë!  
Unë shpirtin tënd e kam në gji,  
dashurisht në gjoks atë e mbaj.

## PRANË GRURIT

Më ndjek në gëzime vallja  
e kallzave të rënuara në fushë,  
shpirti s'më rri pa kënduar,  
këngën s'e mbyll dot nën buzë.

Fshatarët të qetë po kthehen  
buzëmbremjes në fshatin e bukur,  
koha e shqetësuar hepohet  
nga duart — në kokrrën e grurit.

## BALLI I BABAIT

Në ballin e babait tim aq të mirë,  
kur isha fëmijë kalonte dora ime,  
gishti i vogël mbetej nëpër një të çarë  
nëpër mend më vinte kujtimi i një beteje.

Gjurmën e plumbit ai e ka në ballë,  
në atë gjurmë buçet kohë e ikur.  
Dorën përmbi të shpesh kalon me mall  
e përkëdhel si një fëmijë të dhemshur.

Një jetë të tërë e mbajti ai në ballë  
si dhe shumë baballarë të tjerë.  
Më thoni, o njerëz, a s'duken ato vallë  
lule mbi lulet që sjell çdo pranverë?

U çanë ballrat e baballarëve  
po kurrë s'thamë na u prish bukuria.  
Ne nuk kërkonim rrugë të tjera  
të na vinte liria.

## KRAHËT E NËNËS

Me krahë dashurie më mbështjellë sa herë  
në prehrin tënd aq të ngrohtë.  
Kush harron të bjerë në atë prehër  
diçka të madhe humbet në botë.

Atje do të bie plot mall dhe e thinjur  
e vetja papritur do më duket fëmijë.  
Dikur sikur shtoheshin vitet, kur mbështetesha.  
A nuk e ka ndier këtë çdo njeri?




## KËNGË PËR TY

Më kujtohet shpesh mësuesi i parë  
ai atëherë ishte fare i ri  
e kushedi, ndoshta përmbi ballë  
mund t'i jenë ulur një tufë thinja tani.

Por unë e kujtoj ashtu të ri  
me sytë e qeshur e të bukur si yje  
dhe ai na kujton me siguri  
ashtu të vegjël përmbi abetare.

A-b-c-në na mësoi ai  
ne cicërimin si zogjtë në pyje,  
ato fluturojnë nëpër vitet e tij,  
cicërima të ëmbla, cicërima fëmije.

Tani ne të rritur bankat kemi lënë  
nga fronte të ndryshme të përshëndesim!  
Nga larg dëgjoje, mësues, këtë këngë  
për ty buron pas pesëmbëdhjetë vjetësh.



Do të rrjedhin edhe shumë të tjerë  
e kënga për ty do më bëhet më e fortë,  
ti ballin lehtë do lëmosh atëherë  
i pabindur do të rrjedhë një pikë lot.

E nxënësja jote do të vijë ndër mend,  
çamarrokja e vogël e bankës së parë,  
ajo që tani mëson nxënës e thur këngë,  
ajo që për ty ka mall.

## GJITHMONË TË KAM PRITUR

Gjithmonë të kam pritur  
drejt meje ti të vije  
siç pret dallëndyshja  
një prej të katër stinëve.

Gjithmonë të kam pritur  
në ëndrrat e mia  
siç pret ara bujkun,  
siç pret nënën fëmija.

Ç'më erdhe ti kështu  
i bukur si një diell,  
ky gazi im seç ndezi  
dhe yjet lart në qiell.

Bashkë ne do të ecim  
ditëve që do vijnë  
së bashku në shtegtime  
hapësira do përpijmë.

## MOTIV I PAHARRUAR

Bareshës së vogël me qengja në duar  
lulebardha i çelin gëzimet në sy  
për blegërimat që rendin papushuar,  
s'e tremb shiu as vapa që ndez dielli.

Dhe iku një ditë në udhën tonë të madhe  
u ul në auditor mes shokëve të gëzuar,  
blegërimat që e rritën në ato male  
e ndjekin kudo — motiv i paharruar.

## NË JETËN PA KUFË

Shpesh kam përkundur  
në ëndrra një fëmijë  
si valëzat një lundër  
në detin pa kufi.

Qumështin e bardhë  
t'i japë pikë-pikë,  
të pinë buzët e vogla,  
të pinë dhe të rriten.

Dhe toka rrit kallinjtë,  
dhe molla frutin rrit,  
nga trungu i së sotmes  
e nesërmja lëshon bisk.

Gjithmonë kam përkundur  
në ëndrra një fëmijë,  
si valëzat një lundër  
në detin pa kufi.

Në jetën pa kufi...

## DUKE PARË NJË DALLËNDYSHE

Nga auditori ne dolëm bashkë  
era dridhej midis duarve, midis buzëve,  
pranvera shqetësohej në degët e njoma,  
një dallëndyshe ngrinte folenë mes drurëve.

Pamë ne dallëndyshen dhe pastaj  
i hodhëm njëri-tjetrit një shikim kuptimplotë.  
Sytë tanë thanë atë çast  
atë që buzët ende s'thoshin dot.

## MBI TË GJITHA KËNGËT

Lindin fëmijët dhe rriten  
të lumtur; të lumtur,  
mbi supet e brishtë të ditëve,  
mbi dashurinë e zjarrtë të prindërve.

Rriten fëmijët  
rendin agimëve  
e si zogj të gëzuar cicërijnë  
këngën e këngëve,  
që ngrihet gjer te retë,  
këngën për Partinë.

Nesër do të burrërohen fëmijët,  
do të harrojnë shumë gjëra,  
pas do të lënë fëmininë  
por nga buzët e tyre do të gurgullojë  
kënga e këngëve,  
kënga për Partinë.

## DALE, MOJ E MIRË

Kthehesha nga fusha  
kallzat mes qempikëve  
fëshfërinin ëmbël  
motive të ditëve.

Seç më dërdhnin gjoksit  
qindra melodira  
me tone të ëmbla,  
me tone të lira.

Përmes melodish  
me sy përkëdhelja  
grurin dhe një djalë  
flokë kaçurrela.

Me gëzimin rendja  
mes fushës së artë:  
— Dal, moj ti, e bukur,  
moj vetullahark.



Dale, moj e mirë,  
ta dish, moj, të dua,  
do të marr për jetë,  
do të marr për grua.

Prush u ndezën ëndrrat,  
rrihite kraharori,  
ngjyrë trëndafili  
fytyra më mori.

## SHOKU IM

Le të thonë ç'të duan  
për shokun tim të mirë  
ka dhe njerëz të vegjël,  
ka dhe njerëz të tillë.

Që bërrylin e lëvizin  
dhe syrin shkelin fap  
tek ecim të shkujdesur  
ne rrugës me asfalt.

Ka dhe njerëz të tillë  
që stonojnë vazhdimisht  
në kohën tonë të madhe  
të rendit socialist.

Të thonë ata ç'të duan,  
s'do t'i lemë rehat, ta dinë,  
ndaj mbajmë në këmbë, të rreptë  
për ta gjithë shoqërinë.

## PLAKUT XHA VASIL

Plaku xha Vasil i urtë, shtatpak  
sa herë më jep letrat ve buzën në gaz,  
kur nga i fejuari ajo vjen  
buzëqeshja e tij edhe më e gjatë.

E di që e kam marrë me dashuri  
ndaj dhe më ngacmon nga pak.  
Teksa iki gjithë dashamirësi  
vështron lumturinë që më sjell ky çast.

## KAM ËNDËRRUAR PËR TY

Dhe për ty kam ëndërruar shpesh,  
dita e bukur e dasmës sime.  
Në ëndrrat vajzërore ti çel  
si yll i bukur që qëndis agime.

Po s'dua të më veshësh fustan të bardhë  
dhe as taksì të bukur që rrëshqet lehtë.  
Në ëndrra s'të mbaj dot të tillë,  
në ëndrrat e mia plot forcë e jetë.

Nga ëndrrat dasma do më ikë një ditë  
në një stinë të bukur do të vijë ajo.  
Ndoshta atëherë do të jenë pjekur qershitë  
dhe unë gjithmonë për ty do të mendoj.

Në qytezë mes shokëve të mi vullnetarë  
do të çel ajo ditë si një gëzim i ri,  
si lulëkuqja petalet mes grurit në arë  
as në ëndrra ti s'njeh të tillë bukuri.

# N Ë N Ë

*(vjuhrrës sime)*

Akoma s'ma njihje ngjyrën e syve,  
as zambakun e bardhë të qeshjes në buzë  
por sa shpejt t'u bënë të afërta, nënë,  
sikur vetë më rrite bashkë me birin tënd.

As unë s'e njihja portretin tënd  
veç dija se në të rrinte një nënë  
me udhë të kryqëzuara në fytyrë,  
të hapura thellë nga një jetë e tërë.

Veç dija se në të rrinte një nënë,  
dhe nënat i duan gjithë bijtë njësoj,  
ndaj malli im vrapon në gjirin tënd  
mbështetet i zjarrtë e pëshpërit, nënë!

## SI NJË ZOG I RRALLË

Nën tingëllimën e emrit tënd, bir,  
vrapon e shfrenuar zemra ime,  
O, si mund të ndalet ardhja e pranverës,  
bukuria që s'vdes e kësaj stinë.

Sa herë të mbështes në prehrin tim  
ti më cicërin si një zog i rrallë  
rritur viseve tona të bukura  
me gjakun që s'kursyem, larë.

Pastaj pulit syçkat në një gjumë të ëmbël  
tek lehtas të përkund me ninulla,  
nëpër to derdhet fëshfërim' e grurit.  
Bir! Duaje këtë fëshfërimë!

Atëherë do më qesh buza për ninullat e thëna  
borën përmbi krye do të ma shkrijë gëzimi,  
mbi supe s'do më bien thinja  
kur nga ara e bollshme të më kthehet biri.

## USHTAR BASHKË ME NE

Sa fishekë zbrazën këngët e tua,  
Memo, komisari ynë,  
gëzhojat që mbetën u mbushën me lule,  
lule për lirinë.

Sa vranë fishekët e këngëve të tua,  
e këngëve që gati janë  
në qoftë se guxon të shkelë këmbë e huaj  
të zbrazen breshëri bam-bam.

Dhe në qoftë se ti në prehrin e lirisë  
fle kaq i qetë, kaq i lumtur  
kjo sepse bashkë me ne  
ushtar atdheut për çdo kohë i je radhitur.

## ME SIGURI

Si kërcejnë zogjtë degë më degë  
e mbushet hapësirë e qiellit tim me valle.  
Ç'të jetë vallë kjo hare, ky gaz,  
që nis nga fushat e ngjitet në male?

Me siguri për grurin e pjekur  
që valëzohet i artë tutje në arë  
për t'i mbushur atdheut sofrën e madhe,  
sofrën e bardhë.

Për derdhjen e zjarrtë të çelikut tonë,  
çelikut me markën shqiptare  
hidhen këta zogj degë më degë,  
hidhen e s'mbahen fare.



## ECJA JONË

Ka nga ata që thonë me mosbesim,  
sepse vetë na thurkan dy vargje,  
qoftë dhe shumë:

— Vajzë ajo, mesër nënë,  
poezia do kohë, poezia do punë.

Teorizojnë kështu për kohën, poezinë,  
pamundësinë e vazhdimit tonë.

Ecja jonë e sigurt, e fortë,  
një botë e tërë, që shëmb çdo mikrobotë.

## E VETMJA FJALË

Sa fjalë e rëndë kjo fjala: jetime.  
Nuk e dëgjoj dot fare,  
dhe është i vetmi bashkim gërmash  
që urrej më bukurinë e gjuhës sime.

Dhe kjo s'është një ndjenjë e kotë  
por një revoltë më se e drejtë.  
Si mund të gjesh mes nesh jetimë,  
njeri që i vetëm fare të jetë?

Si mund të gjesh një njeri të tillë,  
kur mes nesh jeton e madhja nënë Parti?  
Në krahët e saj unë rritem e lumtur,  
në krahët e saj edhe një fëmijë.

Ndaj mos ta dëgjoj më atë fjalë: jetime.  
Të gjithë e kuptoni, është fare e kotë,  
arkaizmat le të flenë në kohën e tyre  
këtë fjalë për atje le ta nisim tok.

## NXËNËSIT E MI

Të urtë e të mirë i kam nxënësit e mi,  
gjithmonë kureshtarë para çdo të reje  
i thithin ato me shpejtësi, si ujin  
buzët e çara të tokës buzë vjeshte.

Dhe i dua përtej të zakonshmes  
për etjen që s'ia shuaj dot,  
vetëm kështu ata do t'i bëhen  
atdheut ndërtonjës të zot.

I mendoj tek punojnë në heshtje  
dikë mes ugarit, dikë në avion  
e nesërmja e tyre, sa e bukur,  
e nesërmja e tyre — vazhdimësia jonë!

## BOTA JONË

Bota jonë, botë e shqetësuar,  
shqetësimi i saj nuk më tremb aspak  
se kam busull për t'u orientuar,  
ecjen ta kem veç ballëlart.

Bota jonë, botë e shqetësuar  
në prehrin e saj mbështeta vargun tim  
që kënga mos më rrjedhë e qetuar,  
që kënga të më rrjedhë me gurgullim'.

## MALET TONA

Sa lule kanë malet tona,  
lule erëmirë,  
malet tona madhështore  
zemërxhevahirë.

Malet tona plot me shkrepë,  
shkrepë për armiqtë,  
me fole, fole të ngrohta  
për zogjtë, për miqtë.

Malet tona — kockë e fortë  
që s'u thyen kurrë,  
as nga gjylet, as nga bombat,  
as nga izmat llumë.

Sa lule kanë malet tona,  
lule erëmirë,  
malet tona madhështore,  
madhështi e paarrirë.

Historisë të patundur  
me ta qëndruam ne,  
ndaj ti rridh, moj kënga ime,  
si krojet prej tyre.

## NË UZINËN E TELIT

Telat zgjaten, zgjaten;  
zgjatimi i ëndrrave punëtore.

Çelin petale në lulet e llampave  
në zemrën e dheut poshtë në galeri,  
çelin të kuqe kuotave në ngjitje,  
çelin horizonteve të ditëve kù eci  
si shkëndijëza dielli.

## NËNTOKA JONË

Zbresin nga lartësitë gjeologët  
në duar — mineral,  
në sy — zemrën e bardhë.

Ngjiten nga thellësitë minatorët  
në duar — mineral,  
në zemër — diell.

Nëntoka jonë  
e ngrohtë,  
e pasur,  
e bukur,  
plot jetë,  
si mbi tokë.

## EMRI IM

Emrin e një nëne më kanë vënë  
që lindi një djalë trim për këtë dhe.  
Me emrin Gjergj e quajti toka ime  
dhe gjysmëhëna turke e thirri Skënderbe.

Sa herë që i hipte kalit ai trim  
gjysmëhëna turke kishte perëndim.  
Vojsava erdhi gjer te ne si Vjosa  
ajo midis nesh rri gjithmonë nënë.

Emrin e një nëne trimi më kanë vënë,  
në emrin tim Gjergja të rinj rriten.



## PËR NË LIDHJEN E SHKRIMTARËVE

Sa ankth e emocione atë ditë,  
trokisja për herë të parë  
dhe s'desha që trokitja ime  
të mbetej e vetme, e parë.

Por të isha mikeshja e kësaj dere,  
të hyja e të dilja këtu gjithmonë,  
të thoshja kështu thjesht e çiltër  
copëza të bukura që ka bota jonë.

Bota jonë, bota e vajzës  
dje gjer te perçja, sot pa kufi  
prandaj te kjo derë, bujare për të gjithë,  
unë do të vi, gjithmonë do të vi.

# NJË QYTET ATJE NË JUG

*Sarandës*

Linda në një qytet atje në jug,  
ku këngën valët nuk e lënë kurrë.

Linda në një qytet të bukur atje në jug,  
mes peshkatarëve, njerëzve të thjeshtë,  
ku natyrës më shumë ia shton bukurinë  
djersa që breron përherë.

Linda në një qytet të bukur atje në jug  
ku rrjeta peshkatarësh nga porti hyjnë e dalin,  
ku shtatin në rritje qyteti im  
si në pasqyrë shikon nëpër valë.

Si rritja e tij e bukur, e sigurt  
goftë rritja ime, e vargut tim të thjeshtë!

## VAJZA NGA FSHATI

E shoh çdo agim tek zbret mbi timon  
Majlinda, ajo vajza nga fshati.  
U ndodha një ditë mes bashkëfshatarëve të saj  
e ndoqëm në heshtje andej nga vajti.

E humbur ashtu pas zhurmës që tretej  
prisja të më thoshin diçka këta flokëbardhë,  
se fjalët ata i kanë aq me vend,  
mendimi i tyre — filozofi e gjallë.

Të më thoshin diçka për vajzën mbi timon.  
Çfarë ndienin ata këtë çast?  
Por ata ndenjën ashtu të heshtur  
si para grurit kur hedhin në thasë.

## ULUR RIMË BASHKË

Të dy në një stol  
mbrëmjeve të bukura  
seç na rrahin zemrat  
sa rrahje të lumtura!

Në ditët që vijnë  
fushë ngjyrëkaltër  
me feksje ylberi,  
dashuri e pastër.

Ja në këtë stol,  
ulur rrimë bashkë  
ç'na vështron kjo hëna,  
ç've buzën në gaz.

Dhe që nga ky stol  
nisin rrugë të mëdha,  
koha në harresë  
gjithë hënat i la.

Stoli ku ne rrimë  
i ri është përjetë  
në të tjera mbrëmje  
shumë të tjerë pret.

## NJË MËNGJES

Pashë një mëngjes shumë ëndrra,  
më shumë se gjithë mëngjeset e tjerë,  
ndërsa jashtë bardhësia përfshinte gjithçka  
dëbora jashtë zgjaste flokë të thinjura.

Pashë shumë ëndrra një mëngjes.  
gjithë ëndrrat e moshatarëve të mi me radhë  
teksa zgjateshin ato flokë të thinjura,  
teksa shtrihej ajo pafundësi e bardhë.

## NGJYRA E KUQE

Thonë se kjo ngjyrë është simbol i dashurisë  
por ne nuk e kemi vetëm kaq,  
mbi të gjitha simbolin e lirisë.  
flamurit derdhur nëpër palë.

Me të kemi rendur nëpër kohëra  
errësirën e shekujve duke çarë.  
Kanë dashur të na e vënë dhe ndënë këmbë  
por ne e kemi mbajtur veç në ballë.

Thonë se kjo ngjyrë është simboli i dashurisë.  
Jo, jo, kjo është shumë pak,  
nëse ne e quajmë të tillë  
për ngjyrën e kuqe kjo është një anë.

Thonë se kjo ngjyrë është simboli i dashurisë.  
për ne, vetëm kaq, është fare pak  
ajo është ngjyra e tokës sonë.  
shiheni si farfurin fap-fap.

## NA I ÇELI LIRIA

Kjo mbrëmje e trëndafiltë nga çeli  
e kaq i bukur horizonti më ngjan  
megjithëse tokës sime bukuria kurrë  
s'i ka munguar, bile bukuri e rrallë.

Kjo mbrëmje e trëndafiltë kurorë e gjallë  
mbi kryet e maleve të lartë,  
kush e thuri kaq bukur vallë?

Cila duarartë?

Çelën, yjet e pikuan një nga një  
mbi petalet. Skuqën trëndafilin.  
Trëndafili i lirisë — flakërim i horizontit  
nga gjaku i të rënëve ndezur.

## IMAZH I BUKUR

Është një pemë aty në fund të fshatit  
dallëndyshet, kur kthehen, aty ulen së pari.  
Trokasit të gëzuara në gjoksin e njerëzve:  
— E, dëgjoni?... Erdhi behari.

Në çdo ardhje i mirëpres këta zogj,  
veç t'i dëgjoni sa ëmbël këndojnë!  
Të tilla këngë thonë zemrat e dashuruara,  
këngë që të lumturojnë.

Është imazh i bukur ky i hyrjes  
të kujton trokitjen e dashurisë së parë.  
Dëgjojeni! Dhe patjetër do t'ju rrahë zemra  
nën kujtimin e saj.

Më ndjek nga pas ky imazh i bukur  
e dua dhe unë, s'e fsheh dot,  
le të rrjedhë kënga si kroi mes zallit  
për ndjenjën e pastër, dashurinë e fortë!



## BUZËQESHJA E FËMIJËS .

Buzëqeshja e fëmijës  
e ngrohtë si dielli,  
si krojet e freskët,  
e bardhë si agimi  
si liria e shtrenjtë.

Buzëqeshja e pastërt e fëmijës  
vazhdimësia e gëzuar e jetës.

## KUR JAM PARA KËNGËS

Kur jam para këngës,  
ndjej mijëra tinguj të më pushtojnë,  
mijëra zëra të ëmbël, të bukur  
ardhur nga jeta jonë,  
që zhurmon në fushë, e oshëtin në mal  
nga buzë e vogëlushit, këmbimi i turnit,  
nga thellësia e tokës, ku nxjerrim mineral,  
gjer lart, ku mbahet hapi i avionit...

Kur jam para këngës,  
djersët më mbulojnë ballin, rrjedhin çurk,  
se s'dua të jetë delikate, e butë,  
se dua që ajo të jetë e fortë,  
dua të jetë  
kumbimi i jetës sot.

## PËRSE KAM DASHUR

S'kam dashur kurrë të më thonë:  
— Tani u rrite, erdhe në kohën tënde,  
shihe atë djalë, ç'deli djalë,  
moj për kokën time, shihe!

Këtë zë të ashpër, të rëndë, metalik  
s'kam dashur ta dëgjojë kurrë.  
Ai humbet në botën time  
si guri kur bie në lumë.

Kam dashur për shok një djalë të ndershëm,  
një djalë të urtë, të thjeshtë e të mirë  
që krah t'ij në jetë të eci  
me hap të lirë.

Me të të jem e sigurt në hapin që hedh  
tek ecim të dy me vështrimin para,  
e lirë të bukurën të ndjej  
tek rritet në këngë, në ballë, në ara.

Ja përse kam dashur ta zgjedh vetë  
shokun e një jete të tërë bashkë.

I urrej sa s'thuhet krushq e mbles,  
nga qenia koha ata m'i flaku jashtë.

## MAJASH SHKREPIN RREZE

Ç'fryn kjo erë e malit  
edhe zbret në fushë,  
ç'më shpupuris flokët,  
ç'më puth dhe në gushë.

Ç'fryn kjo erë e malit  
dhe më vë në buzë  
fjalë partizani  
flakë edhe shpuzë.

Para, shokë, para,  
majash shkrepim rreze,  
rritu, ti, moj farë  
e ditëve të nesërme.

Ç'fryn kjo erë e malit  
dhe gjoksin ma mbush,  
me këngë partizani,  
thënë, moj, me pushkë!

Erë e zjarrtë e luftës,  
rrahje e fortë e zemrave  
fry nga shtegu i viteve,  
fry nga shtegu i këngëve...

## NUK ËSHTË E LEHTË. . .

Nuk është e lehtë të dashurosh,  
të mbash një të dytë në qenien tënde,  
të të ngatërrojë të rrahurat në gjoks,  
qdo çast të të trokasë në mendje.

Kështu më ndodh me ty, poezi,  
nga vetja, si vallë, s'të ndaj dot?  
Ju e kuptoni me siguri,  
nuk është e lehtë të dashurosh!

# MBETI NËPËR KËNGË

— Dëshmorit Adem Sheme —

1.

Rritej Ademi në varfërinë e pandarë  
me dashurinë për liri gjer në diell.

Rriteshe.

Në gjoksin tënd  
ninullat derdhnin  
prushin e kuq të dashurisë për tokën, për njerëzit.

Nga kraharori i nënës mirrnin jetë ninullat,  
ninullat e nënës — brilant dashurie,  
nëpër to gurgullon i bardhë heroizmi  
me krisma lirie.

Rriteshe.

Mbi shpatulla varfëria të uli  
thasët e rëndë të çimentos  
po më të rëndë se thasët  
çizmjat e të huajit — dhimbje në gjoksin tënd.



Shpirti me dhimbje,  
buza me këngë  
këngë për liri.

Me shkrepje krismash  
brohoritje fitoresh  
të një populli.

Dallgë e shkumëzuar ç'tu rrit kënga  
furtuna e urrejtjes atë e përplaste  
mbi armiqtë, që tokës m'i rëndonin  
në çdo gur, plis e copëzë balte.  
Dhimbja e kthyer në forcë  
rritej hakmarrje,  
ziente revoltë.

Ç'dua vallë më shumë se liria,  
ç'dua më shumë se toka mëmë?  
Qartësinë e së vërtetës na e dha Partia,  
shokë, në këmbë!

\*  
\*  
\*

Maleve tona të rendim krahëshqiponjë  
krenarinë mbi ballë,  
pushkën mbi supe ta mbajmë,  
me thirrjen e të gjitha kohërave:  
Para partizanë!

Të rendim, të rendim si dallga nëpër det  
maleve tona,  
maleve tona që u ngjajmë aq shumë.

\* \* \*

Toka ime!  
Djegur gjer në dhembje për liri.  
Më ke ndier?  
Çdo sekondë kam jetuar për ty.  
Ka aguar 8 Nëntori,  
në krehrin tënd përjetësisht le të hyjë!

Unë biri yt,  
mes bijve të tjerë,  
barrikadë e shtypjes  
në shekuj mbetça e ndritsha si yll!

Kish kohë që toka shqiptare s'kish parë  
një copë qiell të pastër,  
rreze qoftë edhe një,  
derisa 8 Nëntori i madhërishtëm  
hyri në histori.

Dhe çeli mbi male një blerim të ri  
me tytat e pushkëve partizane,  
kurora lirie me trëndafilë të kuq  
rriteshin  
nga tytat në gjokset djaloshare.

2.  
Iku Ademi mes shokëve në male,  
kur netët digjte urrejtja shekullore,  
kur agimet, si trëndafil në prehrin e stinës  
hidhte e hidhte lufta popullore.

\* \* \*

— Nënë!  
Me Vjosën babait çoi fjalë  
(zërin e nënës e dëgjojnë dhe valët)  
yt bir ka ulur një yll përmbi ballë  
(nga drita e syve të tu ai rrezaton)  
me bebzën e syrit  
shënjestrën gradon, gradon.  
Nëse rrëke gjaku do mbulojnë trupin tim  
nëpër ato do të ndiej hapat e Shqipërisë së lirë  
e do buzqesh gjer në pambarim.  
Plumbi do më bjerë mbi buzëqeshjen,  
ajo, si për çudi,  
do mbetet trëndafil...

E nesërmja do të vinte e madhe, e madhe  
e thoshte këtë pushka partizane,  
e thoshte këtë zëri i Partisë,  
e thoshin këtë djemtë e nënave,  
rrahja e fuqishme në gjoks të Shqipërisë.

E nesërmja do të vijë e madhe, e madhe  
kumboi llogorja një agim.  
Do të vijë, do të vijë, do të vijë...  
Vazhdoi jehonë e tij.

Ishte zëri që mbeti i Ademit<sup>\*</sup>  
urrejtja e klasës, që forcën i dha.  
Atë e përcjellin oxhakët e fabrikave  
furrnaltat e çelikut lart në re,  
buzët tona nëpër breza  
flladi i lirë mbi ty, atdhe.

Mes flakëve zbritën agimet e sotëm  
mbushur me hapat e njerëzve të rinj  
që të qeshur ecin udhëve të jetës,  
që udhëve të jetës ecin të lirë.  
Ra e mbeti ai nëpër këngë  
kënga djepi për bijtë e rënë!

Është i dhemshur prehri i tokës  
toka — mëmë e vërtetë.  
Nënë përmbi nënat  
bijtë gjallë i mban përjetë.

\* \* \*

Shalli yt me ngjyrë të gjakut  
me gjuhë krismash flet në muzeum.  
Ne rreth tij mblidhemi të etur,  
ne rreth tij duam të dimë aq shumë.

Moshën e pionierit ai shall zbukuron,  
gjoksin e vogël të yllkave në rritje,  
në gjoks të atdheut yllkat medalion  
me reflekse drite.

Adem! Vendi yt në vargun e të rënëve  
rrahje të fortë në gjoksin e këngëve,  
vargu i të rënëve  
lavdi që ndrit në ballë të atdheut,  
vargu i të rënëve...  
Vargu i këngëve...

Çelin lulet

e mbushin kraharorin e gjerë të stinës;

stina e lirisë

më e bukura stinë.

Buzëqeshja e të rënëve mbi petale

në çdo vit që vjen

çel e përtërirë.

✽

\*

\*

Në gjoksin e tokës mbështeta  
frymëzimin tim të merrte jetë.

Midis të rënëve i pavdekshëm Ademi

ndaj unë e përshëndes me vargun tim të thjeshtë!

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Ëndrrat .....	3
Unë dhe gjyshi .....	4
Kur çelin ëndrrat .....	5
Duart e muratorëve .....	6
Më kot .....	7
Malësorja .....	8
Bij aksionesh .....	9
O kjo dashuria .....	10
O fantazi e fëmijëve .....	11
Jam dashuruar .....	12
O Joni ynë .....	13
Pranë grurit .....	14
Balli i babait .....	15
Krahët e nënës .....	16
Këngë për ty .....	17
Gjithmonë të kam pritur .....	19
Motiv i paharruar .....	20
Në jetën pa kufi .....	21
Duke parë një dallëndyshe .....	22
Mbi të gjitha këngët .....	23
Dale, moj e mirë .....	24
Shoku im .....	26
Plakut xha Vasil .....	27
Kam ëndrruar për ty .....	28
Nënë .....	29
Si një zog i rrallë .....	30
Ushtar bashkë me ne .....	31
Me siguri .....	32

Ecja jonë .....	33
E vetmja fjalë .....	34
Nxënësit e mi .....	35
Bota jonë .....	36
Malet tona .....	37
Në uzinën e telit .....	38
Nëntoka jonë .....	39
Emri im .....	40
Për në Lidhjen e Shkrimtarëve .....	41
Një qytet atje në jug .....	42
Vajza nga fshati .....	43
Ulur rrimë bashkë .....	44
Një mëngjes .....	45
Ngjyra e kuqe .....	46
Na i çeli liria .....	47
Imazh i bukur .....	48
Buzëqeshja e fëmijës .....	49
Kur jam para këngës .....	50
Përse kam dashur .....	51
Malesh shkrepin rreze .....	53
Nuk është e lehtë .....	55
Mbeti nëpër këngë .....	56